



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:107785
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05692740

C.nr.536/19

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve-kundër të paditurve B., A., dhe B.B. dhe S.L. e lindur B., të gjithë nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson shoqëria e avokatëve “ISTREFI” nga Prishtina, kundër të paditurve N.M. nga V.B. rr. ..., nr. ... të cilin e përfaqëson av. Shpëtim Vishi nga Kaçaniku dhe të paditurit-kundërpaditësit S.E. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av. Kemajl Ademaj nga Ferizaj, me objekt kontesti sipas padisë vërtetim i pronësisë dhe me objekt të kontestit sipas kundërpadisë lirim prone, pas mbajtjes së seancës përgatitore të dt. 15.05.2024, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse mori ndërsa, me datë 16.05.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet se është tërhequr padia e paditësve B., A., dhe B.B. dhe S.L. e lindur B., të gjithë nga Ferizaj, kundër të paditurit N.M. nga ..., në raport me ngastrën kadastrale nr. ...-10 ZK Ferizaj.

A r s y e t i m

Paditësit, kanë ushtruar padi në këtë gjykatë më 20.05.2019 kundër të paditurve N.M. dhe S.E., me objekt kontesti vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit 3,100€.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. Jeton Idrizi nga shoqëria e avokatëve “Avokatura ISTREFI SHPK” me seli në Prishtinë, në seancën përgatitore të dt. 15.05.2024 e kanë njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë kundër të paditurit N.M. nga ..., në raport me ngastrën kadastrale nr. ...-10 ZK Ferizaj meqenëse palët e kanë bartur pronësinë në procedurë jashtëgjyqësore, ndërkaq në pjesët e tjera mbetem në tërësi pranë padisë, kërkesëpadisë dhe parashtresës.

I autorizuari i të paditurit të parë N.M., av. Shpëtim Vishi nga Kaçaniku, nuk e kundërshtoi tërheqjen e padisë ndaj klientit tim në raport me ngastrën kadastrale ...-10.

Gjykata në seancën përgatitore të dt. 15.05.2024 e ka konstatuar tërheqjen e padisë së paditësve kundër të paditurit N.M. nga ..., në raport me ngastrën kadastrale nr. ...-10 ZK Ferizaj, ndaj të cilit aktvendim përfaqësuesi i paditësve, përfaqësuesi i të paditurit të parë nuk kishte vërejtje ndërsa përfaqësuesi i të paditurit të dytë kishte vërejtje në vendimin e marrë si dhe kërkoi nga gjykata nxjerrjen e aktvendimit të veçantë në formë të arsyetuar.

Nga të gjitha të lartcekurat, konform nenit 261 të LPK, në të cilin parashihet se: “261.1 Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi. 261.2 Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë. 261.3 Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë. 261.4 Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi. 261.5 Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.”, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1, pika c, të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Datë 16.05.2024

Gj y q t a r i
Armend Ahmeti

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK.